

URDHËR
Nr. 602, datë 16.12. 2022

PËR PËRDITËSIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT NR. 72, DATË 2.3.2017,
“PËR MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve”, I
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, si dhe të pikës 6.3, të kreut VII, të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) rinovohen regjistrimet për 3 (tre) lëndë vepruese, nga të cilat 2 (dy) lëndë vepruese me rrezik të ulët, bashkëlidhur këtij urdhri;

b) zgjaten afatet e regjistrimit për 1 (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

c) Hiqen 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

1. RINOVohen REGJISTRIMET (RIREGJISTRIM) PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1.1 LËNDA VEPRUESE *Pythium oligandrum* strain M1

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Pythium oligandrum strain M1 Koleksioni i kulturës nr. ATCC 38472	Jo e aplikueshme	Jo papastërti relevante	1.3.2023	28.2.2038	Për zbatimin e parimeve uniforme, konkluzionet e raportit të rinovimit, të merren në konsideratë. T’i kushtohet vëmendje e veçantë për specifikimet e materialit teknik si të prodhuar komercialisht. Mbrojtja e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat në vetvete konsiderohen si sensibilizues të mundshëm dhe se efektet fizike në sistemin e frymëmarrjes për shkak të mbetjeve të mjedisit të kulturës dhe të bashkëformulantëve në Produktin Mikrobial (MPCP) nuk mund të përjashtohen. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa

						për zbutjen e rrezikut, të tilla si: - pajisje adekuate mbrojtëse personale dhe mbrojtëse të frymëmarrjes për operatorët që përdorin produkte që përmbajnë shtamin <i>Pythium oligandrum</i> M1.
--	--	--	--	--	--	---

1.2 LËNDËT VEPRUESE ME RREZIK TË ULËT:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Fish oil (vaj peshku) CAS No: 8016-13-5 CIPAC No: 918	Jo e aplikueshme	Pastërtia minimale e substancës aktive siç është prodhuar: Vaj peshku 100%. Identiteti i papastërtive përkatëse (me shqetësim toksikologjik, ekotoksikologjik dhe/ose mjedisor) në substancën aktive siç është prodhuar: Nivelet maksimale për papastërtitë e mëposhtme, në përpjesëtim me vajin e peshkut me përmbajtje lagështie prej 12%: 5 ng/kg e shumës së dibenzo-paradioksinave të poliklorinuara (PCDD) dhe dibenzofuraneve të poliklorinuara (PCDF) (3); 20 ng/kg e shumës së dibenzo-paradioksinave të poliklorinuara (PCDD), dibenzofuranëve të poliklorinuara (PCDF) dhe bifenileve të poliklorinuara të ngjashme me dioksinën (PCB) (4); 0,5 mg/kg mërkur; 2 mg/kg cadmium; 10 mg/kg plumb; 175 µg/kg PCB jo të ngjashme me dioksinën.	1.3.2023	28.2.2038	Për zbatimin e parimeve uniformë, konkluzionet e raportit të rinovimit për fish oil, të merren në konsideratë. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme.
2	Heptamaloxyloglucan CAS No: 870721-81-6 CIPAC No: 851	α-L-fucopyranosyl-(1→2)-β-D-galactopyranosyl-(1→2)-α-D-xylopyranosyl-(1→6)-[α-D-xylopyranosyl-(1→6)-β-D-glucopyranosyl-(1→4)]-β-D-glucopyranosyl-(1→4)-D-glucitol	≥ 780 g/kg. Papastërtia e mëposhtme është një shqetësim toksikologjik dhe mjedisor dhe nuk duhet të kalojë nivelet në materialin teknik: - Patulin, maks. 50 µg/kg.	1.3.2023	28.2.2038	Për zbatimin e parimeve uniformë, konkluzionet e raportit të rinovimit për fish oil, të merren në konsideratë. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme.

2. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

Deri më 15 dhjetor 2023:

1. Glyphosate

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

3. HIQEN LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. 1,3-dichloropropene

Lënda vepruese *black soap E470a* nuk është e miratuar.

2. Chloropicrin

Lënda vepruese *calcium propionate* nuk është e miratuar.

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.